



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

TEDA TIRANË SH.P.K.

Nr. 23 prot.

Tiranë, më 03. 9 .2024

Lënda: Shpallje për vende të lira pune.

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Bulevardi “Bajram Curri”, 8 RHJ, Tiranë

Të nderuar,

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Vendimit Nr. 54 datë 30.05.2024, “Për krijimin e Shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e Akteve të Themelimit”, TEDA Tiranë sh.p.k. shpall procedurat e konkurimit për vendet e lira:

1- Specialist të Marketingut;

Lutemi nga ana juaj, shpalljet bashkëlidhur të publikohen në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

TEDA TIRANË SH.P.K.

SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

PUNONJËS ME KONTRATË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), Vendimit Nr. 54 datë 30.05.2024, “Për krijimin e Shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e Akteve të Themelimit”, TEDA Tiranë sh.p.k. shpall procedurat e konkurimit për vendet e lira:

➤ Specialist të Marketingut.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të kenë të kryer nivelin e diplomës në master shkencor;
3. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
4. Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;
5. Preferohet të ketë minimumi 5 vite eksperiencë pune në fushën e marketingut;
6. Preferohet të ketë njohuri mbi administratën publike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesë për aplikim;
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e Kartës së Identitetit;
4. Çertifikatë e përbërjes familjare;
5. Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
6. Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
7. Fotokopje e librezës së punës.
8. Motivacioni i largimit nga puna e fundit (në se është i punësuar ose ka qenë i punësuar);
9. Raport mjeko-ligjor;
10. Vërtetim i gjendjes Gjyqësore;
11. Dy fotografi (2.5 x 3.5 cm).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo në sportelet e Sektorit të Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët ndodhur në rrugën e Kavajës, Godina 205, Njësia Administrative, Njësia Bashkiake nr.7 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të taksave Vendore brenda datës **09.09.2024**.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, TEDA Tiranë sh.p.k. do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë në stendat e informimit të publikut, pranë Bashkisë Tiranë.

Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Tiranë. Afati i ankimimit është **3 ditë** nga data e shpalljes së fituesit.